



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Dep.	Prot. No.
Nr. Traj.	Data:
Broj stranica	Datum:
Nr. pages	Date
02	30-04-2014
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.04.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-1084/14, për z. Ylber Hysa – Ambasador i Republikës së Kosovës në Maqedoni, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojn dyshimin e arsyeshëm për gjendje të mundshme të Konflikti të Interesit në ushtrimin e funksionit publik, por zyrtari i lartë ka disa kufizime.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-1084/14, për zyrtarin e lartë, z. Ylber Hysa – Ambasador i Republikës së Kosovës në Maqedoni, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik

Pas informatës së marrë, Agjencia ka filluar procedurën e hetimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë z. Hysa, për ushtrimin e funksioneve si Ambasador i Republikës së Kosovës në Maqedoni, Anëtar i Këshillit Kombëtar të Cilësisë, dhe si Hulumtues i pavarur shkencor në degën e Historisë të Institutit Albanologjik të Kosovës.

Agjencia, si institucion i pavarur, që ndër të tjera bën mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, pas shqyrtimit të provave në dispozicion ka konstatuar se ushtrimi i funksionit si Ambasador i Republikës së Kosovës në Maqedoni dhe si Anëtar i Këshillit Kombëtar të Cilësisë është i lejuar dhe nuk paraqet situatë të gjendjes së Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik, ndërsa funksionin si Hulumtues i pavarur shkencor në degën e Historisë të Institutit Albanologjik të Kosovës, zyrtari i lartë z. Hysa e ka pezulluar për periudhën e kohëzgjatjes së ushtrimit të funksionit të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Maqedoni, duke filluar prej datës 01.03.2013.

Sa i përket funksionit publik, si Anëtar i Këshillit Kombëtar të Cilësisë, konsiderojmë se z. Hysa mund ta ushtroj këtë funksion nën kufizimet e parapara në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ligji në fjalë përcakton se zyrtari i lartë mund të ushtroj veprimtari tjera krahas ushtrimit të funksionit publik. Ushtrimi i këtyre veprimtarive parashihet në nenin 10 (paragrafi 2) në të cilin thuhet: *“Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”*.

Megjithatë, neni 15 (paragrafi 3) i po këtij ligji parasheh kufizimet gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve. Në këtë nen shprehimisht thuhet: *“Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, por nuk ka të drejtë të pranimi të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”*.

Bazuar në këtë dispozitë, z. Ylber Hysa, si Anëtar i Këshillit Kombëtar të Cilësisë mund të pranoj kompensimin e përcaktuar me Vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (Nr.075/01, të datës 29.05.2013), por jo të pranoj kompensim për shpenzime të udhëtimit dhe shpenzime tjera të nevojshme.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

